



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1577 Prot.

Tiranë, më 22.122017

VENDIM Nr. 245, datë 13.12.2017

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.13, datë 13.12.2017, pasi shqyrtoi Relacionin e verifikimit në terren, në kuadër të *projektit "Ndërtimi i Nënstacionit të ri në Fushë Krujë"*-subjekti OSHEE sh.a., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Vangjel Dimo.

VENDOSI:

1. Të miratojë Relacionin e verifikimit në terren, në kuadër të *projektit "Ndërtimi i Nënstacionit të ri në Fushë Krujë"* -subjekti OSHEE sh.a., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Vangjel Dimo.
2. Në rast se gjatë zbatimit të punimeve identifikohen gjetje arkeologjike, bazuar në nenin 48 të ligjit 9048, datë 7.4.2003 "Për Trashëgiminë kulturore" (i ndryshuar), subjekti zbatues duhet të ndërpresë menjëherë punimet dhe të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KIMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO